ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KOSTT-21-170-2-2-1**, dhenr. ibrend. **KOSTT5329/12-21-04-221**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara (oborreve) të nënstacioneve 400, 220 dhe 110 kV**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NNP "WENDA"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Fshati Dolak
(Adresa)

Vushtrri 42000
(Vendi)(Kodi postar)

044/197 814
(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Kadri Selmni
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

wenda.v@liv.com
(Adresa elektronike)

07.04.2021
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë"apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit",nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë është: 25.01.2021
Afati për dorëzimin e ofertave: 26.02.2021
Hapja e Ofertave: 26.02.2021 ora : 10:00
B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK –me date 19.03.2021 ora: 13:51 me Letrat Standarde për eliminim
Kërkesa për rishqyrtim: 23.03.2021
Vendimi mbi refuzimin ne kërkesën për rishqyrtim 29.03.2021

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Ne procesin e hapjes te këtij aktiviteti te prokurimit kemi marr pjese dhe nuk kemi vrenjtur ndonjë parregullsi gjate procesit te hapjes.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 23.03.2021 kemi bere kërkesën për Ri-shqyrtimi tek AK, kurse me datën 29.03.2021 nxjerr vendimin për refuzim te pretendimeve tona lidhur me këtë aktivitet te prokurimit. Mirëpo AK nuk shqyrton pretendimet tona fare vetëm arsyeton se kemi respektuar LPP duke mos e trajtuar fare me çështjet e ngritura ne pretendimet tona ankimore dhe shqetësimet tona lidhur me ketër aktivitet te prokurimit edhe perkunder qe qe kemi dorezuar referenca pozitive per pune te njejta si ne dosje te tenderit dhe njoftimit per kontrate

Pra me fjale tjera AK ka refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim ne kundërshtim me **nenit 108/A par. 9 dhe 12** dhe aty mundohet te arsyetoj shkeljet qe kane ndodhur ne vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave, sepse përkundër qe kemi kërkuar mënyrën se si ka llogaritur komisioni i vlerësimit piket tona dhe te kandidates te shpallur fitues nga AK, përsëri nuk ka dhen dhe nuk ka arsyetuar sepse ZPP është shume i vetëdijshëm për shkeljen e dispozitave ligjore te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apoNjoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Pretendimet e mia lidhur me shkeljen e dispozitave ligjore te LPP si ne vijim:

1. **Neni 1të LPP-së**
2. **Neni 2 par. 1 dhe 2 te LPP-se**
3. **Neni 6 te LPP-se**
4. **Neni 7 te LPP-se**
5. **Nenin 52 par. 3 dhe 7 te LPP-së**
6. **Neni 56 par. 3 te LPP-së**
7. **Neni 59 te LPP-se**
8. **Neni 60 të LPP-së**
9. **Neni 40.2, 40.11 te RUOPP-se**
10. **Nenin 108/A te LPP-se**

*** Sipas Nenit 118të LPP, OSHP-ja do tëkthejtarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kaneqenëte rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti kontraktues KOST ka udhëhequr aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara (oborreve) të nënstacioneve 400, 220 dhe 110 kV"**dhe nr. prok.: **KOSTT-21-170-2-2-1,** dhenr. i brend. **KOSTT5329/12-21-04-221.** Si palë me interes ne këtë procedure te prokurimit e pakënaqur me udhëheqjen e kësaj procedure nga AK - ZPP dhe me arsyetimin ne eliminimit parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim duke ngritur pretendimet e mia si ne vijim:

Të nderuar, ne me datë: 19.03.2021 në platformën elektronike të prokurimit kemi pranuar njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku për kontratë ka propozuar N.N.SH. "Ndertimtari" – Skenderaj, ndërsa neve na ka

shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se:*Ne ofertën tuaj nuk keni prezantuar dy kontrata ne lidhje me shërbimet ngjashme ne 3 vitet e fundit, ku se paku njëra prej tyre duhet te jete per shërbime te ngjashme (kositje te barit) te realizuar nen stabilimentet e tensionit te larte.*

Ne besojmë se AK, gjate procedurës se prokurimit publik, ka shkelur dispozitat ligjore dhe rregullat e LPP-se, për faktin se ne e kemi përmbushur kërkesën e lartcekur dhe jemi OE i përgjegjshëm pasi përveç kërkesës së lartcekur i kemi plotësuar edhe të gjitha kërkesat tjera të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Duke marr per baze kërkesat e dosjes se tenderit – FDT-se ku thotë:

Kërkesat mbimundësitë teknikedhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Deklarata mbi specifikimet teknike**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Deklarata e nënshkruar mbi përmbushje kërkesave të specifikimit teknik .**
		2 kontrata në lidhje me shërbimet ngjashme në 3 vitet e fundit, ku së paku njëra prej tyre duhet të jetë për shërbime të ngjashme(kositje te barit) të realizuara nën stabilimente te tensionit te lartë.	- **Një listëqë** specifikon parimet relev të performancës që specifi shërbimet e ngjashme; shumër kontratës; datën dhe pranuesin, - **Të dëshmuara me 2 certifikata pranimit apo 2 referenca shërbimet të ngjashme,** përgjatë viteve te fundit nga data e publikim njoftimit për kontrate, ku së paku n prej tyre duhet të ofrohet për shërb të ngjashme(kositje te barit) realizuara nën stabilimente te tens të lartë.

Fillimisht ju sqarojmë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron për faktin se ne e kemi përmbushur kërkesën e lartcekur dhe jemi OE i përgjegjshëm pasi përveç kërkesës së lartcekur i kemi plotësuar edhe të gjitha kërkesat tjera të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Faktin se ne i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dëshmohet përmes listës se kontratave te prezantuara nga ana jone dhe kësaj liste i 'ja kemi bashkangjitur 2 (dy) referenca ne te cilat shkruan shume qart se OE ka kryer me suksese, kositjen e barit (kositja e sipërfaqeve) nen tensionin e lart te rrymës.

Provë:Lista e kontratave dhe 2 (dy) refenca pozitive ku thohet qarte: kositja e barit nen tensionin e lart te rrymës.

Nëse eventualisht AK-ja ka pasur ndonjë dilemë ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së ose eventualisht ta vërtetoj vetë përmes komunikimeve me trupën akredituese.

AK ka shkelur **nenin 1 dhe 2 te LPP-se** duke shkelur parimin kryesore te prokurimit **Vlerën për papa**, pasi këto dy nenenpërcaktojnë rregullat, procedurat të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Pasi qe ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, mirëpo AK – Komisioni i Vlerësimit dhe ZPP nuk kane respektuar këto dispozita ligjore duke na eliminuar krejt ne kundërshtim me këto nene sepse arsyetimi ne letrën standarde te eliminimitështë pas asnjë sqarim konkret si dhe nuk ka asnjë baze ligjore te LPP-se.

Pra duke marr parasysh këto kritere për dhënie dhe kërkesat teknike ose profesionale si dhe duke u bazuar ne procesverbalin e hapjes ku oferta jone ishte me çmimin me te ulëte, mirëpo komisioni i vlerësimit dyshojmë se nuk ka vlerësuar sakte dokumentet tona, dhe ka vepruar ne kundërshtim ne **nenin 56 par. 3 te LPP-se,** ku thotë: *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është I cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*., prandaj kjo te vjen ne përfundim se AK – Komisioni i vlerësimit – ZPP nuk kanë vepruar sipas dispozitave ligjore te LPP-se , duke e favorizuar OE e rekomanduar për kontrate i cili është duke kryer shërbime te tilla nga maj i vitit 2016 dhe duke na diskriminuar neve ne këtë aktivitet te prokurimit edhe përkundër pse kemi prezantuar dy referenca pozitive për kositjen e barit – hapësirave nen tensionin e lart te rrymës, mirëpo përkundër kësaj AK me qellim te caktuar dhe ne kundërshtim te nenit **1, 2, dhe 6 e LPP-se**, duke shkelur"**vlerën për paranë"** si parmin kryesor te prokurimit, si dhe duke shkelur kriteret e përcaktuar vet ne FDT-se si dokument themelorëpërpërgatitjen e ofertave, na eliminon me një arsyetim pa mbështetje ligjore te LPP-se si dhe ne kundërshtim me **nenin 59 dhe 60 te LPP-se**, pasi qe ne kemi ofertuar me çmim me te ulet te përgjegjshëm si dhe plotësojmë tegjitha kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin kryesor te shpërblimit te FDT-se ne këtë aktivitet te prokurimit.

Gjithashtu nga sqarimet me larte sapo kemi pranuar Njoftimin përeliminimpërmesplatformës ne menjëherë me date 19.03.2021 kemi kërkuar qasje ne dokumentet sipas nenit 10 te LPP-se, kurse AK përmes me ane te telefonit na lejon qasjen ne dokumente me datën 22.03.2021 nga ora 14:00.

Duke marr për baze dokumentet qe kemi pranuar ne qasje përmes USB, ne kemi analizuar dokumentet e prezantuara nga OE me çmimin me te ulet se sa ne dhe kemi konstatuar se asnjë nga OE nuk kane prezantuar referenca qe dëshmojnë se kane realizuar pune te kositjes se barit nen tensionin e lart, andaj ne jemi te sigurt se ne plotësojmë këtë kritere dhe kemi prezantuar një liste me kontrata dhe kemi dëshmuar me 2 (dy) referenca pozitive për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave te brendshëm dhe te jashtme, ku cekët se kemi **kositje te barit nen tensionin e larte** ashtu siç është kërkua ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura shihet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e ofertes tonë është i pa bazuar dhe nuk qëndron dhe mund te rregullohet permes dispozitave ligjore te LPP-së, konkretisht **nenit 1, 2, 6, 7, 56, 59, 60 të LPP-së.**

Përfundimisht autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka respektuar **nenin 59 të LPP-së**, sepse na ka eliminuar neve edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa unë kam ofruar çmimin me te ulet ne këtëaktivitet te prokurimit dhe sigurisht aty kam arrit avantazhin pasi kam fituar piket maksimale ashtu siçështëkërkuar ne FDT.

AK-ja me këtë vlerësim dhe vendim na ka diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe njëkohësisht e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e shpallur fitues edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Autoriteti kontraktues është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Autoriteti kontraktues është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 2 të LPP-së, pasi dihet se Ky ligj vlen për të gjithë personat, operatorët ekonomik, dhe ndërmarrjet, ashtu si përcaktohen këto terme në këtë ligj, që janë të përfshirë, marrin pjesë ose interesohen, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në aktivitete prokurimi të rregulluara me këtë ligj; nga personat e tillë, operatorët, dhe ndërmarrjet gjithashtu kërkohet që t'i respektojnë dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat procedurale dhe materiale të këtij ligji.

Andaj kërkojmë nga OSHP ta analizoj dhe te veprojë ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së, duke aprovuar pretendimet e ngritura dhe te nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE: **NNP "WENDA"**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së, për dhënie te kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontrate dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne OSHP dhe ne institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet material janë te mëdha ne përgatitjen e këtij tenderi ne aspektin material mbi 50 € si dokumente për te regjistruar dhe ngarkuar ne platformën elektronike si dhe përgatitja e ankesave nga avokatet 200 €, për këtë procedure te prokurimit, qe me shpenzime tjera si pije, ushqim dhe kohen për pritje për përpilim te ankesës nga avokatet kalon vlerën prej 300.00 Euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP,Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*